



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 108 / 2020

Datë: 01 / 12 / 2020

Në mbështetje të nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (08.06.2020) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - nr. 07/2020, si dhe nenit 24/B (paragrafi 4) të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Arbresha Morina emërohet Zyrtare në Divizionin për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.
2. E emëruara nga pika 1 e këtij Vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruares në pikën 1 të këtij Vendimi fillon me datë 01.12.2020 dhe zgjatë deri 01.12.2022 përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër.
4. Të ardhurat personale të të emëruares nga pika 1 e këtij Vendimi do të paguhën si pagë primare në vlerë prej 480 euro bruto në muaj.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Selim SELIMI
Ministër i Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- Të emëruares Znj. Arbresha Morina;
- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;

- *Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Divizionit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara dhe*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*